


# TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE

Prill 2026

Në Prill 2026 eksportet e mallrave arritën vlerën 34,9 mld lekë, duke u rritur me 16,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 6,8 %, në krahasim me Mars 2026. Importet e mallrave arritën vlerën 79,0 mld lekë, duke u rritur me 4,4 % në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me 1,6 %, në krahasim me Mars 2026. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 44,1 mld lekë, duke u ulur me 3,8 %, krahasuar me një vit më parë dhe me 7,4 %, në krahasim me Mars 2026.


**FIG. 1 TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS MUAJVE, NË MILIARD LEKË**



## Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve

Gjatë muajit Prill 2026, në rritjen e eksporteve prej 16,9 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +9,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +6,6 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,4 pikë përqindje, etj. Negativisht kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -1,8 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” dhe “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,2 pikë përqindje, etj.


**FIG.2 KONTRIBUTI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR TË EKSPORTEVE, PRILL 2026**



**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve**

Gjatë muajit Prill 2026, në rritjen e importeve prej 4,4 %, krahasuar me një vit më parë, kanë ndikuar pozitivisht grupet: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me +2,5 pikë përqindje, "Ushqime, pije, duhan" me +2,1 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me +0,4 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht ka ndikuar grupi: "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me -0,8 pikë përqindje, "Prodhime druri dhe letre" me -0,1 pikë përqindje, etj.

**FIG.3 KONTRIBUTI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR TË IMPORTEVE, PRILL 2026**



## Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere

Në muajin Prill 2026, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Prill 2025 janë: Kosova (26,0 %), Gjermania (28,9 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rënien më të madhe, janë: Italia (3,8 %), Spanja (20,6 %), etj.

Në muajin Prill 2026, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Prill 2025 janë: Italia (3,1 %), Kina (18,9 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rënien më të madhe, janë: Turqia (0,8 %), Gjermania (3,6 %), etj.

Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 53,8 %, të gjithë tregtisë. Në Prill 2026, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 62,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,1 % të importeve gjithsej.

**TAB. 1 QARKULLIMI I MALLRAVE, PRILL 2026**

Vitet	Muajt	Eksperte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		367	35,0	784	29,6	-423	46,0
2022		481	30,9	950	21,2	-464	51,2
2023		430	-10,4	873	-8,2	-432	50,5
2024		369	-14,3	894	2,5	-526	41,2
2025		346	-6,1	887	-0,8	-541	39,0
2025	01 - 25	28	-4,5	60	0,1	-32	46,4
	02 - 25	30	-5,3	68	-8,6	-37	44,6
	03 - 25	31	-4,9	74	-1,4	-42	42,5
	04 - 25	30	-13,3	76	0,5	-46	39,5
	05 - 25	32	-7,9	78	-2,1	-46	41,0
	06 - 25	31	-9,0	77	-0,2	-45	40,8
	07 - 25	30	-6,9	83	-2,4	-53	36,5
	08 - 25	20	-8,4	67	-2,7	-47	30,1
	09 - 25	27	-10,7	75	5,6	-48	36,3
	10 - 25	31	1,0	80	3,6	-49	39,1
	11 - 25	28	-6,9	71	-3,0	-43	39,5
	12 - 25	27	5,6	80	1,3	-53	33,6
	Jan-Dhj	346	-6,1	887	-0,8	-541	39,0
2026	01 - 26	27	-4,5	58	-4,0	-31	46,2
	02 - 26	31	2,8	68	0,8	-37	45,5
	03 - 26	33	4,1	80	8,8	-48	40,7
	04 - 26	35	16,9	79	4,4	-44	44,2

## Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Tregtia e Jashtme](#)

# Metodologjia

## Njoftim i rëndësishëm për përdoruesit

Publikimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme, është subjekt i rishikimeve metodologjike, të cilat mbështeten në të dhënat administrative nga autoritetet doganore.

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicione

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv. Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor. Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovakia, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri